



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1099/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Burim Ademi, kryesues, Milena Đjeric dhe Ferki Xhaferi, anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë Arta Ymeri nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vushtrrisë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 09.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht i bazuar apeli Anr.1099/2021, i paraqitur nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë Arta Ymeri nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vushtrrisë, me të cilën ka kërkuar rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimin VV 2701B/09R.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vushtrrisë, në Vendvotimin VV 2701B/09R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në vendvotimin e vendosur si në pikën **-II- të këtij** dispozitivit të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet e pabazuar pjesa e apelit e paraqitur nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë Arta Ymeri nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vushtrrisë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet KQZ-ja, për ti rinumëruar fletëvotimet në vendvotimet VV 2702B/02R dhe VV 2708B/02D.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 08.11.2021 ka pranuar apelin Anr.1099/2021 (përmes postës, të datës 04.11.2021) kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë, Arta Ymeri nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vushtrrisë në të cilën pretendon se në Vendvotimet VV 2701B/09R, VV 2702B/02R dhe VV 2708B/02D, në Komunën e Vushtrrisë ka pasur parregullsi ashtu që e njëjta ka pasur më shumë vota mirëpo të njëjtat nuk i janë shënuar nga ana e komisionerëve. Si dëshmi krahas apelit ka bashkangjitur deklaratat e nëntë votuesve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë Arta Ymeri nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vushtrrisë, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në Vendvotimet VV 2701B/09R, VV 2702B/02R dhe VV 2708B/02D, në komunën e Vushtrrisë, sa i përket numrit të votave për kandidat.

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket vendvotimit VV 2701B/09R, të vendosu si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, nga se rezulton se në këtë vendvotim kandidatja në fjalë ka bashkangjitur gjithsej katër deklaratata të votueseve ndërsa nga verifikimi i të dhënave zyrtare të ofruara nga KQZ i figurojnë vetëm 3 vota, prandaj paneli konstaton se ka mospërputhje të rezultatit përfundimtar me deklaratatata e votueseve, andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi..

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitim të kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, të vendosur si në pikën -IV-, të dispozitivit paneli, vlerëson se kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë, Arta Ymeri, nga Subjekti Politik LDK, dega në Vushtrri me të cilin kërkon rinumërimin e votave për vendvotimin VV 2702B/02R është i pa bazuar për faktin se për të njëjtin vendvotim, KQZ-ja veç e ka marrë vendim për rinumërim para se rezultati përfundimtar të publikohet andaj të njëjtat janë të rinumëruara, për këto arsye paneli vlerëson se një rinumërim tjetër për të njëjtin vendvotim të rinumëruar nga KQZ-ja në QNR, është i pa arsyeshem. Ndërsa sa i përket vendvotimit VV 2708B/02D apeluësja nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1099/2021 më datën 09.11.2021

Kryesues i Panelit

Burim Ademi

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.

